

KLSH merr pjesë në Workshop-in mbi Promovimin e “Parlamentit të Hapur”

Më datë 5 nëntor 2024 u organizua në Tiranë workshop-i mbi promovimin e “Parlamentit të hapur” në Shqipëri, situata aktuale dhe plani për përmirësim. Në këtë workshop morën pjesë z. Genci Gjoncaj me detyrë Sekretari i Përgjithshëm i Parlamentit të Shqipërisë, znj. Valbona Kuko, Drejtor i Fondacionit Westminster për Demokraci (WFD), z. Simon Charter, Drejtor i Programeve dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Ambasadën e Britanisë së Madhe në Shqipëri, z. Zef Preçi, Drejtor i Qendrës Shqiptare për Kërkime Ekonomike si dhe ekspertë dhe profesionistë nga Organizata të Shoqërisë Civile. KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga z. Aulent Guri dhe znj. Esmeralda Hoxha.



Takimi nisi me një fjalim hapës të z. Zef Preçi mbi avantazhet që sjell një parlament i hapur, transparent dhe llogaridhënës. Ai eksploroj dhe solli në vëmendjen e të pranishmëve rrugëtimin dhe sfidat që e kanë shoqëruar Parlamentin e Republikës së Shqipërisë ndër vite sa i përket transparencës mbi veprimtarinë e tij duke theksuar rëndësinë që ka transparenca e institucioneve publike në përgjithësi dhe Parlamentit të Shqipërisë në veçanti. Më tej, sipas axhendës, krahas diskutimeve të përfaqësuesve të sipërpërmendur u prezantua një vlerësim mbi transparencën e Parlamentit i realizuar nga ekspertet Brunilda Kosta dhe Zyhrada Kongoli. Në prezantimin e tyre ato përshkruan metodologjinë e përdorur për vlerësimin e Parlamentit të Shqipërisë sa i përket transparencës së tij duke theksuar qartë kriteret dhe indikatorët e përdorur për të arritur në këtë vlerësim. Prezantimi i tyre zgjoi mjaft interes jo vetëm te përfaqësuesit e Parlamentit por edhe te pjesëmarrësit e tjerë duke bërë pyetje dhe parashtruar mangësi apo nevojë për përmirësim në transparencën që Parlamenti duhet të pasqyrojë te qytetarët dhe jo vetëm. Takimi vijoi me diskutime mbi situatën aktuale si dhe nevojat për përmirësim duke u bazuar kryesisht edhe në gjetjet dhe konkluzionet e vlerësimit të realizuar nga znj. Kosta dhe znj. Kongoli.